



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 46 al. 2 të Ligjit për planifikimin dhe rregulimin e hapsirës ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 2/89), nenit 3 të Rregullorës mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më. 13.06.2003 merr

## **V E N D I M**

### **MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS KARDIOKIRURGJIKE NË PRISHTINË**

#### Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kardiokirurgjike, në Prishtinë

#### Neni 2

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Qendrës Kardiokirurgjike, në Prishtinë.

Lokacioni nga alinea 1. e këtij neni, përfshin pjesën e ngastrës kadastrale nr. 1794/1, Komuna Kadastrale Prishtinë, sipërfaqja prej 1.50.00 ha pronë e Komunës.

Lokacionit nga alinea 2. të këtij neni, i ndryshohet destinimi nga ai i paraparë me PPU si sipërfaqe për gjelbërim, në sipërfaqe për ndërtimin e objektit sipas të cilit është caktuar ky lokacion.

#### Neni 3

Dhënia, kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të lokacionit nga neni 2 al.2 i këtij Vendimi, do të rregullohet me kontratë të vacantë në mes të Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe investitorit që ndërton objektin për të cilin është destinuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

#### Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për hartimin e Projektit Urbanistik të lokacionit nga alinea 2 e nenit 2 e këtij Vendimi, në bazë të të cilit do të caktohen kushtet urbanistike- teknike për lejimin e ndërtimit të objektit intensiv nga neni 2 i këtij Vendimi.

Projekti Urbanistik nga alinea 1 e këtij neni do të punohet nga Drwejtorati i Planifikimit, urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës sipas programit të prezantuar nga investitori.

#### Neni 5

Projekti Urbanistik i Lokacionit sipas këtij Vendimi do të inkorporohet me planin detal urbanistik të ardhshëm për hapsirën e gjërë të asaj zone të Qytetit.

#### Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorati për Financa dhe Pronë, të Komunës së Prishtinës, do ta kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

#### Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01.NR.353-1118 DT.19.06.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**